



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4238 Prot.

Tiranë, më 04.07. 2023

URDHËR

Nr. 336, Datë 04.07.2023

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“GJUHËSI E APLIKUAR NË FUSHËN E TURIZMIT”, TË UNIVERSITETIT “ISMAIL
QEMALI”, VLORË, ME UNIVERSITETIN E SALENTOS, ITALI**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e dyfishtë në “Bachelor” në “Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, dhe Fakultetin respektiv në Universitetin e Salentos, Itali, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit”, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, dhe Fakultetin respektiv në Universitetin e Salentos, Itali, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të përmbushë rekomandimet e ekspertëve, para fillimit të vitit akademik 2023-2024, në lidhje me:
 - a) Plotësimin e formave të vlerësimit të dijeve me provim/firmë.
 - b) Riformatimin e syllabuseve sipas vendimit nr. 41 datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar dhe paraqitjen e literaturës së pesë viteve të fundit.
 - c) Specifikimin e institucioneve ku do të kryhet praktika profesionale.
4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së dyfishtë në “Bachelor” në “Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit”, të lëshuar nga ky universitet, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

